

*EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshtetarëve Sharri*

*2 dhjetor 2011, Prizren*

## **KOMUNIKATË PËR MEDIA**

*Dhunimi i demokracisë dhe shkelja e vullnetit të qytetarëve të Prizrenit*

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dje ka publikuar një informatë në lidhje me projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Në këtë informatë thuhet se kjo Misistria ka amendamentuar projekt-ligjin! Ky është një lajm sensacional për demokracinë në Kosovë, ngase në mënyrë shumë perfide dhe hipokrite po veprohet që me çdo kusht projekt-ligji të miratohet në seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës më 7 dhjetor. Projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit tashmë një kohë të gjatë gjendet në procedurë të shqyrtimit parlamentar, dhe për më tepër, Kryesia e Kuvendit para disa ditësh ka vendosur që këtë projekt-ligj ta fusë në rend dite të seancës së ardhshme plenare të Kuvendit, që do të zhvillohet me 7 dhjetor. Përmes intervenimit në tekstin e projekt-ligjit (që paradoksalisht Ministria po e quan “amendamentim”) dhe organizimit të debateve publike derisa projekt-ligji është në shqyrtim paralementar dhe ka hyrë në rend dite të seancës së ardhshme plenare, MMPH po e dhunon procedurën demokratike të ligjbërjes në Kosovë. Edhe një herë, po dëshmohet kontrolli total i qeverisë mbi Kuvendin, si dhe dëmtimi i skajshëm i demokracisë në vend.

Ky intervenim po bëhet për të mashtruar opinionin dhe posaçërisht deputetët e Kuvendit të Kosovës se MMPH i ka marrë parasysh kritikën e shoqërisë civile për projekt-ligjin dhe se tash ai i plotëson kushtet për t’u miratuar në seancë plenare. Po i ripotencojmë edhe një herë faktet alarmante rreth këtij projekt-ligji. Në rradhë të parë, ai është në kundërshtim me Pakon e Ahtisaarit, e cila e obligon komunën e Prizrenit dhe jo institucionet qendrore të Kosovës për të themeluar Qendrën Historike të Prizrenit. Së dyti, projekt-ligji i shkel tre nga parimet themelore të Kushtetutës së Kosovës, laicitetin, neutralitetin në çështjet e besimeve fetare dhe mosdiskriminimin. Gjithashtu, ky projekt-ligj injoron tërë kuadrin ekzistues ligjor dhe institucional të Kosovës për mbrojtje të trashëgimisë kulturore. I gjithë procesi i hartimit të këtij projekt-ligji ka dëshmuar për praktikën dhunuese ndaj demokracisë në vend. Veprimi i fundit i MMPH për të “amendamentuar” projekt-ligjin derisa ai gjendet në shqyrtim parlamentar është kulminacion i këtij dhunimi dhe perfiditetit i qeverisë së Kosovës. Për më tepër, projekt-ligji shkel vullnetin e qytetarëve të Prizrenit, të cilët përmes Peticionit me mbi 10.000 nënshkrime janë deklaruar kundër këtij projekt-ligji.

Iu bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të veprojnë në pajtim me Pakon e Ahtisaarit, Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Në të njëjtën kohë, iu bëjmë thirrje që të respektojnë vullnetin e qytetarëve, prej ku buron edhe legjitimiteti i tyre. Në të kundërt, deputetët që do të ngrenë dorën për të votuar këtë projekt-ligj dhe do të përligjin një praktikë dhunuese ndaj demokracisë, përveç që do të shkelin ligjin e Kosovës dhe vullnetin e qytetarëve, ata do të bartin edhe pasojat politike dhe morale të këtij veprimi.

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, në rast të miratimit të këtij projekt-ligji në seancën e 7 dhjetorit do të ndërmarrë veprime më radikale. Hapi i parë do të jetë dërgimi i ligjit në Gjykatën Kushtetuese, pasi që ai qartë e shkel Kushtetutën e Kosovës. Paralelisht, në rast se komuna e Prizrenit e pranon këtë ligj, do të nisim procedurën e largimit të kryetarit të komunës së Prizrenit nga detyra, një e drejtë që na garantohet me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Dhe së treti, qytetarët e Qendrës Historike të Prizrenit do të praktikojnë padëgjueshmëri qytetare ndaj shtetit dhe obligimeve shtetërore. Ne besojmë se në rast se shteti shkel dhunshëm vullnetin e qytetarëve, atëherë edhe qytetarët kanë të drejtë të mos e respektojnë shtetin.

Mbetemi me shpresë se deputetët e Kosovës do t'i thërrasin arsyes dhe do të tregohen të përgjegjshëm në raport me vullnetin e qytetarëve. Në të kundërt, ata do t'i bartin pasojat politike dhe morale të një veprimi dhunues ndaj demokracisë dhe paralizues ndaj funksionalitetit të qytetit të Prizrenit.

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit  
*EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri*